



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 218, datë 27.10.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “KALISI HYDROPOWER” SH.P.K. PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E KUOTAVE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 136/5 prot., datë 21.10.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave të shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. është mbajtëse e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 71, datë 22.04.2020.
- Shoqëria ka vënë në dijeni ERE-n për transferimin e kuotave ndërmjet ortakëve ekzistues të saj.
- Në zbatim të pikës 6.2, të Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të licencuarit mbartin detyrimin për të kërkuar autorizim në ERE në lidhje me ndryshimin e ortakut/aksionerit kryesor.
- Shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut kryesor.
- Shoqëria “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

- Në mbledhjen e Bordit u konstatua nevoja për të sqaruar rrethanat dhe dokumentacionin që lidhet me barrësimin e kuotave të tretët, për të cilat shoqëria ka kërkuar autorizimin e ERE-s për transferimin brenda shoqërisë, ndaj për saktësimin e këtij dokumentacioni dhe zhvillimin e seancave të mundshme dëgjimore për këtë qëllim, në zbatim të nenit 67, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vlerësohet të shtyhet me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrja e bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave.
- Gjatë kësaj kohe shoqëria duhet të depozitojë në ERE shpjegime dhe dokumentacion për sa kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI